



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ADMINISTRACIJE

Nr.faq/Br.shr. 32
Datë/Datum. 16.02.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 16.02.2021

Drejtoria e Administratës

Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

RAPORTI I PUNËS PËR FUNKSIONIMIN E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS PËR PERUDHËN
JANAR/DHJETOR 2021

Shkurt 2021

Përmbajtja e raportit.....	2
Hyrja.....	3
Struktura e raportit.....	3
Qëllimi i raportit.....	3
Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe	
Kuvendit të Komunës.....	4
Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.....	4
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	11

Hyrje

Raporti i Punës për Funksionimin dhe aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa, për periudhën Janar/Dhjetor të vitit 2021 është i bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislativin e Komunës, si organi më i lartë i Komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka miratuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore, Buxhetin e Komunës, Raportin Përfundimtar Vjetor Financiar dhe Raportin Financiar gjashtëmujor.

Struktura e raportit

Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës synon të bëjë një vlerësim për progresin e arritur në përmbushjen e obligimeve ligjore, zbatimin e punëve dhe aktiviteteve, mbështetur në kompetencat e bazuara me ligj si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësisë që lidhen me realizimin e kërkesave të ekzekutivit si dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës.

Struktura e raportit përfshin:

- Funksionimin e Kuvendit të Komunës;
- Funksionimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete;
- Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

Raporti përfshin periudhën Janar/Dhjetor 2021. Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga ekstraktet e procesverbaleve dhe aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës. Raporti shërben për nxjerrjen e një pasqyre dhe konkluzioneve më të hollësishme për funksionimin e Kuvendit të Komunës dhe hapave të cilët duhet të ndërmerren për përmirësime në të ardhmen.

Qëllimi i raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë dhe objektiv të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, për mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Komunës dhe mekanizmave tjerë përcjellës. Raporti pasqyron punën dhe aktivitetet e të zgjedhurve në mbrojtjen e interesave të qytetarëve si dhe shërben si mjet adekuat për rritjen e transparencës së organit më të lartë të komunës, i cili i ka dy funksione kryesore: 1. Funksionin vendimmarrës në shpërndarjen e buxhetit dhe 2. Funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të shpenzimeve.

Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës

1. Komiteti për Politikë e Financa, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, ka për detyrë shqyrtimin e politikave komunale dhe orientimeve strategjike të Komunës, shqyrtimin e aktiviteteve financiare të Komunës, Planin Vjetor të prokurimit publik, Planin Vjetor të auditimit të brendshëm dhe çështje tjera për të cilat jep rekomandime dhe nxjerr përfundime e konkluzione profesionale se si të veprohet në orientimin e politikave programore për zhvillimin ekonomik lokal, rregullimin hapësinor dhe territorial, zhvillimin, rregullimin dhe strukturimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
2. Komiteti për Komunitete, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Po ashtu, gjatë punës së tij, Komiteti për Komunitete, jep rekomandime për Kuvendin e Komunës lidhur me buxhetin, politikat programore për zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
3. Kuvendi i Komunës, si organ më lartë i Komunës dhe organ përfaqësues për subjektet politike, të cilat i përfaqësojnë qytetarët e Komunës dhe e kanë për obligim t'i mbrojnë interesat e tyre. Kuvendi i Komunës, bazuar në kompetencat e tij, propozimet e Ekzekutivit të Komunës, rekomandimet e dy Komiteteve të Përhershme: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, merr vendime për buxhetin dhe çështje tjera financiare, miraton aktet normative nga fusha e veprimtarisë së institucioneve lokale të pushtetit, miraton planet zhvillimore dhe rregullative, bën emërtimin e rrugëve e shesheve në territorin e Komunës dhe vendosë për shumë çështje tjera me interes lokal.

Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës

Janar 2021

1. Vendim për lejimin e shpenzimeve të mjeteve financiare nga kodi i participimit për subvencione në bujqësi për vitin 2021;
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 44, të datës 20.01.2021 për lirimin nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2021;
3. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 45, të datës 20.01.2021, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 60,000.00€, për punëtorët shëndetësorë të punësuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovës, përmes projektit të Caritas Kosova për vitin 2021;

4. Vendim për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2021 në shumë të mjeteve financiare prej 195.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.

Mars 2021

1. Vendim për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2020, në shumën prej 157,692.45€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave dhe mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve nëpër kodet e programeve, nënprogrameve;
2. Vendim për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2020, në vitin fiskal 2021 në shumë të përgjithshme prej 3,023,613.65€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 153, të datës 15.02.2021;
3. Vendim për rishqyrtimin e vendimit Nr. 176, të 16.12.2020 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës
4. Vendim për miratimin e Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënimit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2021

Prill 2021 - mbledhja e parë

1. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 73, të datës 10.06.2020, për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve.
2. Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Shërbime Publike dhe Projekt-Rregullores për menaxhimin e varrezave, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve;
3. Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej pesëmbëdhjetë anëtarëve;
4. Vendim për ndryshimin e vendimit Nr. 63, të datës 06.04.2018, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, lidhur me përbërjen e Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi i subjektit politik nga Partia Liberale Egjiptiane z. Bashkim Krasniqi pas kalimit të tij në Shërbimin Civil të Komunës së Fushë-Kosovës, zëvendësohet me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian, anëtarin e ri z. Hasim Avdullahi.

Prill 2021 - mbledhja e dytë

1. Vendim për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,855,838.58€.
2. Vendim për rrënimin e objekteve të vjetra publike në fshatrat e Komunës së Fushë-Kosovës;
3. Vendim për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për shërim shëndetësorë dhe rehabilitim, për palën Jeton Kelmendi nga fshati Sllatinë e Vogël, për vendosjen e protezës së këmbës së majtë prej gjurit sipas diagnozës: Amputatio cruris sin pp vulnus explosivum.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 246, të datës 20.04.2021, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, në ngastrën kadastrale Nr. P-725140003-00779-7, me sipërfaqe S=9,900m², arë e klasës së pestë, pronë private në vendin e quajtur 'Shume Krivovo' në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afarist Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar 'Eu - Beton', me numër identifikues të biznesit 811327205, pronar Përparim Thaçi. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për zhvillimin e biznesit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 'Eu-Beton', në Zonën Industriale ZI I - Blloku 1215.

Qershor 2021 - mbledhja e parë

1. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 289, të datës 20.04.2021, për këmbimin e sipërfaqës të barabarta të pronës me Nr. 00779-3, me pronën 00002-0, sipas vlerësimit të kryerë nga eksperti i vlerësimit të pronave si vijon: Sipërfaqja e pronës së dhënë në shfrytëzim për 99 vite prej S=281m², në pronësi të Istref Sejdi Elshani dhe Hektor Elez Beqiri, pjesë e ngastrës kadastrale të evidentuar certifikatën e pronës me Nr. P-72514003-00779-3, me sipërfaqe të përgjithshme të saj prej S=00.02.81 ha, arë e klasës së pestë, në vendin e quajtur 'Shume Krivovo', me status ligjor e pa ngarkuar me hipotekë, në Zonën Kadastrale Harilaç, për subjektin afarist 'Arbotec', me numër identifikues të biznesit 810533879, këmbëhet me pronën në sipërfaqe prej 281m², pjesë e ngastrës kadastrale të evidentuar në certifikatën e pronës me Nr. P-72514003-00002-0, P.sh 'Rrugët', me shfrytëzim rrugë e pakategorizuar, në sipërfaqe të përgjithshme të saj prej S=00.17.64 ha në Zonën Kadastrale Harilaç.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 407, të datës 28.05.2021, për themelimin e dy institucioneve të arsimit parauniversitarë në Komunën e Fushë-Kosovës, me përshkrimin dhe strukturën si vijon:
Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Dardanisë, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës;
Shkolla Fillore e Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë në anën e djathtë të rrugës magjistrale M9, me tridhjetë (30) paralele dhe me njëmijë nxënës.

3. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 529, të datës 25.05.2021, për vendosjen e një kontejneri në hapësirën publike të parkingut në oborrin e Komunës së Fushë-Kosovës, për Kompaninë publike Postën e Kosovës sh.a, për krijimin e lehtësimeve administrative të marrjes së shërbimeve publike, për qytetarët dhe institucionet komunale.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 298, të datës 21.05.2021, për ndarjen e pagesave në këste të taksës administrative dhe tarifës për ndikimin e densitetit në Infrastrukturë.

Qershor 2021 - mbledhja e dytë

1. Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2022-2024, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - Për vitin 2022 buxheti i komunës është në shumë prej: 11,656,080.00€;
 - Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,176,483.00€;
 - Për vitin 2024 buxheti i komunës është në shumë prej: 12,748,639.00€.
2. Vendim për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shkelzen Berisha nga fshati Graboc i Poshtëm, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e vajzës së tij Rajana Berisha, e cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Neuroblastoma.
3. Vendim për aprovimin e propozimit për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 14,844.94€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma 5,567.64€, në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma 9,277.30€.
4. Vendim për lejimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Republikën e Shqipërisë.
5. Vendim për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit "Fushë-Kosova", në shumë të përgjithëshme prej: 50,000.00€, me destinim për t'i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës për vitin garues 2021-2022, si vijon:
 - Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 25,000.00€, në vitin buxhetor 2021, do të shërbejë klubit të futbollit për mbulimin e shpenzimeve, në sezonin vjeshtorë të garave kampionale futbollistike dhe
 - Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 25,000.00€, në vitin e ardhshëm buxhetor 2022, do të shërbejë klubit të futbollit për mbulimin e shpenzimeve, për sezonin pranëverorë të garave kampionale futbollistike.

6. Vendim për aprovimin e propozimit për lirim të subjekteve afariste nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, për periudhën kohore nga data 01.07.2021 deri me 31.12.2021.
 - subjektet afariste që e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, lirim nga taksa komunale për zgjatjen e orarit të punës, do ta realizojnë përmes kërkesës në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, për kohën e zgjatur pas orës 23:00h.
7. Vendim për formimin e Grupit Punues për sistemimin e nxënësve sipas rrugëve dhe regjistrimin e tyre në Shkollat Filllore të Mesme të Ulëta në Fushë-Kosovë, për vitin shkollor 2021/2022, në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve.

Gusht 2021

1. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 493, të datës 17.06.2021, për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme e Ulët në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë, me emrin e veprimtarit të çështjes kombëtare Akademik Idriz Ajeti.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 494, të datës 17.06.2021, për emërtimin e Shkollës Filllore të Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë në Fushë-Kosovë, me emrin e arsimtarit të Gjuhës Shqipe dhe veprimtarit të çështjes kombëtare Haki Bajrami.
3. Vendim për aprovimin e propozimit Nr. 866, të datës 26.07.2021 dhe plotësimin e propozimit Nr. 899, të datës 02.08.2021 dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 73,468.80€, për hapjen e procedurës së prokurimit publik për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta, në kohëzgjatje prej gjashtë muajve me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë muaj, për punëtorë në arsimin e Komunës së Fushë-Kosovës për Shkollën Filllore të Mesme të Ulët në lagjen e Dardanisë dhe Shkollën Filllore të Mesme e Ulët në lagjen e Apollonisë.

Shtator 2021 - mbledhja e parë

1. Vendim për lirim nga drejtat, detyra dhe përgjegjësitë të Kryetarit të Komitetit për Auditim të Brendshëm në Komunën e Fushë-Kosovës z. Enver Bajçinca, pasi që është kandidat i subjektit politikë Lëvizjes Vetëvendosje për Kryetar të Komunës së Fushë-Kosovës, në zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021.
2. Vendim për caktimin e Grupit Punues për hartimin e ndryshim-plotësimit të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 142, të datës 07.11.2016, në përbërje prej trembëdhjetë anëtarëve si vijon: Remzi Shala, Jetmir Berisha, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Hysni Hasani, Ejup Qyqalla, Hasan Gjyrevci, Adnan Bullatovci, Faton Berjani, Misin Berisha, Qamil Fejzullahu dhe Maliq Thaçi.
3. Vendim për miratimin në parim të Projekt-dokumentit për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Fushë-Kosovës (PMQU).

4. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 714, të datës 26.07.2021, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm, të automjetit zyrtar të komunës me targa të regjistrimit Nr. 01Z-53-09, Statcionit të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën një vjeçare, me mundësi vazhdimi.

Shtator 2021 - mbledhja e dytë

1. Vendim për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2022, në shumë të përgjithshme prej 11,656,080.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon: për paga dhe mëditje për 776 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,290,000.00€; për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,900,000.00€; për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 260,000.00€; për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 455,000.00€ dhe për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 3,751,080.00€.
2. Vendim për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Agim Bërbatovci nga Fushë-Kosova, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e tij, i cili vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Infiltrating Urothelial Carcinoma, high-grade Carinoma Metastaticum in lyphonodrum (4/6) Hyperplasia benibna prostate (BHP).
3. Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Tetor 2021

1. Vendim për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2021, në shumën e mjeteve financiare prej: 2,280,000.00€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave e shtesave, mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve dhe investime kapitale nëpër kodet e programeve, nënprogrameve dhe projekteve.
2. Për aprovimin e Propozimit Nr. 942, të datës 07.10.2021, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 296,246.40€, për 52 norma në arsim në Komunën e Fushë-Kosovës, për mësimdhënës dhe personel administrativ dhe teknik për vitin shkollorë 2021/2022, nga burimet vetjake të komunës. Shpërndarja e këtyre normave në arsim, është bërë për plotësimin e nevojave pas rritjes enorme të numrit të nxënësve në shkolla të qytetit si vijon: shkollën 'Mihal Grameno', shkollën në lagjen e Dardanisë dhe shkollën në lagjen e Apollonisë, mbështetur në konkurset publike të shpallura në muajin gusht, shtator dhe tetor të vitit 2021 dhe listës pritëse për vitin shkollorë 2021/2022.
3. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për palën Shpresa Qyqalla Jahiri, me vendlindje në fshatin Bardh i Madh të Fushë-Kosovës, me destinim për të ndihmuar në shërimin shëndetësorë dhe trajtimin e djalit të saj Noar

Jahiri, i cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Atrofi Progressive Parenkimale Amaurosis Epi.

Mbledhja inauguruese është mbajtur me datë 03.12.2021, ku e kanë dhënë betimin anëtarët e Kuvendit të Komunës, gjithsej 27 anëtar dhe betimi i Kryetarit të Komunës.

1. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 1049, të datës 24.11.2021, për zgjedhjen e z. Ali Ismaili i lindur me datën 21.03.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovë, me profesion historian, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 1050, të datës 24.11.2021, për emërimin e z. Bashkim Krasniqi i lindur me datën 03.04.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovës, përfaqësues nga Inicativa për Fushë-Kosovën e Egjiptianëve dhe Ashkalinjëve, në pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.

Dhjetor 2021

1. **Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: shtatë (7) anëtarëve si vijon:**
 - 1.1 Ali Ismaili - përfaqësues nga Partia e Drejtësisë, Kryesues i Komitetit;
 - 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3 Mirlina Krasniqi - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Miranda Shabani - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Eglantina Azemi - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.7 Mirsad Qyqalla - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar.
2. **Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: nëntë (9) anëtarëve si vijon:**
 - 1.1 Jetmir Berisha - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Arjeta Jashari - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Shpend Bardiqi - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Dardane Sogojeva Shala - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.5 Artan Asllani - përfaqësues i komunitetit ashkalinjë nga Lista Ndryshe, anëtar;
 - 1.6 Radoman Doderovic - përfaqësues i komunitetit serb nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar;
 - 1.7 Linda Hyseni - përfaqësuese e komunitetit egjiptian, anëtare;
 - 1.8 Fehmi Gashi - përfaqësues i komunitetit romë, anëtar;
 - 1.9 Milica Filipovic - përfaqësuese e komunitetit malazez, anëtar.

3. Vendim për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në përbërje prej: njëmbëdhjetë (11) anëtarëve si vijon:

- 1.1 Ali Ismaili - përfaqësues nga Partia e Drejtësisë, Kryesues i grupit punues;
- 1.2 Fadil Krasniqi - Nënkrjetar i Komunës, anëtar;
- 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
- 1.4 Laureat Gojnovci - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
- 1.5 Habib Mekolli - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
- 1.6 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
- 1.7 Driton Ademi - përfaqësues nga Nisma Socialdemokrate, anëtar;
- 1.8 Hasan Ismajli - përfaqësues nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
- 1.9 Bashkim Krasniqi - përfaqësues nga Iniciativa e Fushë-Kosovës e Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve, anëtar;
- 1.10 Artan Asllani - përfaqësues nga Lista Ndryshe, anëtar;
- 1.11 Radoman Doderovic - përfaqësues nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar.

Është konfirmuar për zbatim: Rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje.

Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje.

Kuvendi i Komunës ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 11 të rregullta dhe mbledhjen inauguruese, janë marrë gjithsej 45 vendime.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka patur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës dhe ekstraktet e procesverbaleve janë të publikuara në ueb-faqe. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkrjetari i Komunës.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

